



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
ORGAN QENDROR BLERËS
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. _____ Prot.

Fier, më ____ .08.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje mjete të ndryshme për nevojat e Bashkisë dhe të Ndërmarrjeve vartëse” me 2 lote:

Loti 1: Blerje kamionçina elektrike të reja

Loti 2: Blerje automjete (pick up) elektrike të reja

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

34136200-1- Kamionçina 34144900-7– Automjete elektrike

VLERA E FONDIT LIMIT TOTAL : Fondi limit / vlera e pritshme e përgjithëshme e kontratës është: **56,517,833** *(pesëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e tetë qind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH ose **fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 07.08.2026): 606 479.59** (gjashtëqind e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e nëntë) Euro*

Fondi limit total i ndarë sipas autoriteteve kontraktore përfituese:

1. Fondi limit i Ndërmarrjes së Pastrimit dhe Higjenes Fier është në vlerën prej 34 960 917 *(tridhjetë e katër milion e nentëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.*
2. Fondi limit i Ndërmarrjes së Gjellbërimit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike Fier, është 10 439 833 *(dhjetë milion e katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.*
3. Fondi limit i Ndërmarrjes së Ujitjes dhe Kullimit Fier, është 7 282 833 *(shtatë milion e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.*

4. Fondi limit i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Fier është 3 834 250 (tre milion e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Loti 1: Blerje kamionçina elektrike të reja – 45 593 583 (dyzet e pese milion e pesëqind e nentëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH ose **fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 07.08.2026): 489 254.02 (katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër pikë zero dy) Euro**

Fondi limit për Lotin nr.1, i ndarë sipas autoriteteve kontraktore përfituese:

- Fondi limit i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Fier është 3 834 250 (tre milion e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.
- Fondi limit i Ndërmarrjes së Pastrimit dhe Higjenes Fier është në vlerën prej 31 319 500 (tridhjetë e një milion e treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.
- Fondi limit i Ndërmarrjes së Gjelbërimit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike Fier, është 10 439 833 (dhjetë milion e katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tridhjet e tre) lekë pa TVSH.

Loti 2: Blerje automjete (pick up) elektrike të reja - 10 924 250 (dhjetë milion e nentëqind e njëzetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH ose **fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 07.08.2026): 117 225.56 (njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e njëzetë e pesë pikë pesëdhjetë e gjashtë) Euro**

Fondi limit për Lotin nr.2, i ndarë sipas autoriteteve kontraktore përfituese:

- Fondi limit i Ndërmarrjes së Pastrimit dhe Higjenes Fier është në vlerën prej 3 641 417 (tre milion e gjashtëqind e dyzetë e një mijë e katërqind e shtatëmbëdhjet) lekë pa TVSH.
- Fondi limit i Ndërmarrjes së Ujitjes dhe Kullimit Fier, është 7 282 833 (shtatë milion e dyqind e tetëdhjet e dy mijë e tetëqind e tridhjet e tre) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier (Organ Qendror Blerës) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Loti 1: Blerje kamionçina elektrike të reja

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës nr.9

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 82 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilin është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit (**2024, 2025**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i

ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabël.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: *”4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”*¹. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në ligjin nr.25/2018, *“Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”*.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

2.2.2 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve (**2024, 2025**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **50 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *”3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”; në pikën 1 dhe pikën 2/a të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 1. ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”

Pika 2/a: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës se perlllogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;”

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/a e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, përkatesisht; në pikën 2/a përcaktohet se: ”2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës se perlllogaritur te kontrates ose lotit, ne procedurat e prokurimit mbi kufirin e larte monetar”, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është i përshtatshëm vendosja e këtij kriterit të përcaktuar në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në:

- nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021, ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;**”
- nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", si dhe rekomandimit të APP-së nr.7998prot, date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore. Njësia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e 2 (dy) viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të kontratës që prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **15 000 000 lekë pa TVSH** (*e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet*), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Per te vertetuar pervojën e mëparshme të ngjashme, operatorët Ekonomik duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me një ent publik, si dëshmi pranohen Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku shënohen vlera, afati I perfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara ose vetëm Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku shënohen vlera, afati I perfundimit të kontratës ose vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe piken 4 të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet përvojës së mëparshme, se zoterojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalog/katalogje të prodhuesit ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit ose skedë teknike të prodhuesit, ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim parametrat

teknikë të produktit (*shih specifikimet teknike*) të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b. fotografitë apo katalogët teknike;”*

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetete ofruara nga operatori ekonomik.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, për mallrat (mjetet) objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, duhet të provohet edhe lidhja midis Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.

Secili nga dokumentat duhet të jetë i vlefshëm, si dhe të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit ose distributorit të autorizuar si: tel, fax, email, website, etj., kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri Ak gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësor të mallit që kërkohet të blihet e që janë prodhuar në përputhje me standartet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtëpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit European ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila duhet të jetë e shoqëruar me certifikatën e konformitetit (CoC) ose ekuivalent të saj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallit, objekt prokurimi. Duke qënë se mjetet janë kërkuar të jenë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE, detyrimisht është kërkuar paraqitja e çertifikatës së konformitetit si dokumenti zyrtar i cili vërteton se një produkt plotëson standartet europiane të sigurtisë, cilësisë, performancës, emetimit të gazrave dhe mbrojtjes mjedisore. Gjithashtu, çertifikata është një nga dokumentet e detyrueshme që shoqëron automjetin për të vijuar me regjistrimin e tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që ka servis të specializuar dhe garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e mjeteve objekt i prokurimit, gjatë periudhës së garancisë në servisin e tij, në një servis të marrë me qira, apo përmes një servisi me të cilin mund të ketë lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, dhe të specifikojë adresën e servisit.

Shënim: Për pikën e mësipërme, operatorët ekonomik ofertues, është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën e mësipërme.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK aktin e pronësisë/kopje e noterizuar, kontratën e qirasë ose kontratën e bashkëpunimit të realizuar sipas formës së kërkuar ligjore dhe të shoqëruar me dokumentacionin ligjor përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 4, të nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomike të vërtetojnë se disponojnë mjediset e përshtatshme për kryerjen e shërbimeve të riparimit brenda periudhës së garancisë.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëpërmjet paraqitjes së një deklarate se merr përsipër:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së mjeteve prej jo më pak se 100,000 km ose jo më pak se 5 vite dhe baterisë së tyre, prej jo më pak se 150,000 km ose jo më pak se 8 vite.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë që malli i ofruar (automjetet) të jenë të reja , të papërdorura.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjeteve të treguara dhe regjistruara në pronësi të Bashkisë Fier, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të

Republikës së Shqipërisë: regjistrimin, targimin me targa shqiptare, leje qarkullimi, siguracion TPL për 1 (një) vit.

- Në cmimin e ofruar të jenë të përfshira edhe karikusat për karikimin e kamionçinave.
- Afati i lëvrimit, jo më shumë se **120 (njëqind e njëzetë)** ditë nga data e lidhjes së kontratës.
- Afati i kolaudit të jetë (*prova, testime në terren*) jo më shumë se 7 ditë kalendarike ose 5 ditë pune.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 8 të nenit 40 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, ku është e cituar: *8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Hartimi dhe argumentimi i specifikimeve teknike, testimi i tregut dhe përllogaritja e fondit limit, si dhe hartimi dhe argumentimi i kërkesave të veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik për zhvillimin e procedurës së prokurimit publik janë të hartuara nga Grupi i Punës i ngritur nga titullari i autoritetit kontraktor, Bashkia Fier, me Urdhërin nr.6050 prot., datë 13.05.2026, në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar.

Specifikimet teknike gjenden bashkëngjitur DST në SPE.

Shënim: Në çdo rast kur në specifikimet teknike mund të jetë e përdorur si referenece emri i ndonje marke apo emri të veçantë, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik, përfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.

Loti 2: Blerje automjete (pick up) elektrike të reja

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës nr.9

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 82 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1. Kopje të certifikuara të balanceve të 2 (dy) viteve të fundit (**2024, 2025**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në

kushtet e parashikuara nga neni 41, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009, *"Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar"*, i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabël.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: *"4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit"*². Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në ligjin nr.25/2018, *"Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"*.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

2.2.2 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2024, 2025**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se **9 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë që nuk tejkalon vlerën e përlogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"* i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.*

Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/b të nenit 43 të VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, perkatesisht; Pika 2/b: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

Duke qene se kjo procedure prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit mbi kufirin e lartë monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me pare gjen se është e pershtatshme vendosja e kriterit të marzheve mesatare të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik, për të mundësuar pjesëmarrje me të gjere të operatoreve ekonomike të interesuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në:

- nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;*”
- nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", si dhe rekomandimit të APP-së nr.7998prot, date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomik-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe

vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore. Njësia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e 2 (dy) viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të kontratës që prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **4 000 000 lekë pa TVSH** (*e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet*), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët Ekonomik duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me një ent publik, si dëshmi pranohen Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku shënohen vlera, afati I përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara ose vetëm Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku shënohen vlera, afati I përfundimit të kontratës ose vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 4 të nenit 40 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 40 % të vlerës

së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendorsja e këtij kriteri behet me qellim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet pervojës së mëparshme, se zoterojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalog/katalogje të prodhuesit ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit ose skedë teknike të prodhuesit, ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim parametrat teknikë të produktit (*shih specifikimet teknike*) të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b. fotografitë apo katalogët teknikë;”*

Vendorsja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet ofruara nga operatori ekonomik.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, për mallrat (mjetet) objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, duhet të provohet edhe lidhja midis Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.

Secili nga dokumentat duhet të jetë i vlefshëm, si dhe të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit ose distributorit të autorizuar si: tel, fax, email, website, etj., kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësor të mallit që kërkohet të blihet e që janë prodhuar në përputhje me standartet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtëpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e

OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila duhet të jetë e shoqëruar me çertifikatën e konformitetit (CoC) ose ekuivalent të saj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallit, objekt prokurimi. Duke qënë se mjetet janë kërkuar të jenë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE, detyrimisht është kërkuar paraqitja e çertifikatës së konformitetit si dokumenti zyrtar i cili vërteton se një produkt plotëson standartet europiane të sigurisë, cilësisë, performancës, emetimit të gazrave dhe mbrojtjes mjedisore. Gjithashtu, çertifikata është një nga dokumentet e detyrueshme që shoqëron automjetin për të vijuar me regjistrimin e tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që ka servis të specializuar dhe garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e mjeteve objekt i prokurimit, gjatë periudhës së garancisë në servisin e tij, në një servis të marrë me qira, apo përmes një servisi me të cilin mund të ketë lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, dhe të specifikojë adresën e servisit.

Shënim: Për pikën e mësipërme, operatorët ekonomik ofertues, është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën e mësipërme.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK aktin e pronësisë/kopje e noterizuar, kontratën e qirasë ose kontratën e bashkëpunimit të realizuar sipas formës së kërkuar ligjore dhe të shoqëruar me dokumentacionin ligjor përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomike të vërtetojnë se disponojnë mjediset e përshtatshme për kryerjen e shërbimeve të riparimit brenda periudhës së garancisë.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëpërmjet paraqitjes së një deklarate se merr përsipër:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së mjeteve prej jo më pak se 100,000 km ose jo më pak se 5 vite dhe baterisë së tyre, prej jo më pak se 150,000 km ose jo më pak se 8 vite.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë që malli i ofruar (automjetet) të jenë të reja , të papërdorura.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjeteve të targuara dhe regjistruara në pronësi të Bashkisë Fier, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë: regjistrimin, targimin me targa shqiptare, leje qarkullimi, siguracion TPL për 1 (një) vit.
- Në çmimin e ofruar të jenë të përfshira edhe karikusat për karikimin e fuoristradave.
- Afati i lëvrimin, jo më shumë se **120 (njëqind e njëzetë)** ditë nga data e lidhjes së kontratës.
- Afati i kolaudit të jetë (*prova, testime në terren*) jo më shumë se 7 ditë kalendarike ose 5 ditë pune.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 8 të nenit 40 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është e cituar: *8.Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

Shënim: Operatoret ekonomike të cilat do të paraqesin ofertat/ konkurrojnë për me shumë se një lot, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta, xhiron vjetore sipas pikes 2.2.2., dhe përvorjen e ngjashme sipas pikes 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Hartimi dhe argumentimi i specifikimeve teknike, testimi i tregut dhe përlllogaritja e fondit limit, si dhe hartimi dhe argumentimi i kërkesave të veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik për zhvillimin e procedurës së prokurimit publik janë të hartuara nga Grupi i Punës i ngritur nga titullari i autoritetit kontraktor, Bashkia Fier, me Urdhërin nr. 6050 prot., datë 13.05.2026, në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike gjenden bashkëngjitur DST në SPE.

Shënim: Në çdo rast kur në specifikimet teknike mund të jetë e përdorur si referenece emri i ndonje marke apo emri të veçantë, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik, përfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shënim: Në respekt të nenit 36 të ligjit nr.16 datë 23.012.2020 “Për prokurimin publik” për çdo standart ose emertim marke të përmendur pranohet dhe ekuivalenti i tyre. Kriteret teknike të kualifikimit janë hartuar nga specialisti i fushës.

Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike gjenden pjesë perberese e DST në SPE.

Njësia e prokurimit :